



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/39

Datë: 22.07.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 22 korrik 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen ekstraktet e procesverbaleve dhe transkriptet nga mbledhjet 31, 32, 33, 34 dhe 35 të Qeverisë.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/39

Datë: 22.07.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 22 korrik 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Energjinë Termike.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/39

Datë: 22.07.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 22 korrik 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Raporti Gjashtëmujor i Buxhetit për vitin 2015.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që raportin nga pika 1. e këtij vendimi ta dorëzoj në Kuvendin e Kosovës konform kërkesave të nenit 45 të Ligji 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeminister i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/39

Datë: 22.07.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 3 të Ligjit Nr. 03/L-220 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-112 për Tatimin e Normës së Akcizës në Kosovë, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 22 korrik 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Vendoset norma e tatimit të akcizës në shumë prej 2€ për kilogram për fishekzjarrët, raketat ndriçuese për sinjale, raketa për kohë shiu, sinjalet për mjegull dhe artikuj të tjerë piroteknike me kodin tarifor 3604.
2. Vendimi Nr. 16/20 i Qeverisë së Republikës së Kosovës i datës 24.03.2015, paragrafi 4, nën paragrafi 2 ndryshohet si vijon, dhe pjesa tjetër e paragrafit 4 mbetet e pandryshuar.
 - 240220 Cigaret qe përmbajnë duhane në shume prej 38€ për 1000 cope/cigare.
3. Vendoset norma e tatimit të akcizës për Lojërat e Fatit si vijon:
 - 3.1. Kazinotë - 7.000.00 (shtatë mijë) euro për çdo muaj kalendarik.
 - 3.2. Lojërat elektronike dhe slot-makinat tjera të vendosura në mjediset e kazinosë - 700.00 (shtatëqind) euro për çdo muaj kalendarik, për çdo kompjuter, makinë elektronike apo slot-makinë.
 - 3.3. Makinat elektronike me më shumë se një pozicion - 700.00 (shtatëqind) euro për çdo muaj kalendarik, për çdo pozicion.
 - 3.4. Baste sportive / subjektet që organizojnë baste sportive - 840.00 (tetëqind e dyzet) euro për çdo muaj, për çdo pikë të shitjes së biletave (basteve sportive).
 - 3.5. Operatorët (subjektet) e lojërave me automate - 700.00 (shtatëqind) euro për aparat, për çdo muaj kalendarik.
 - 3.6. Ruletë për makinat elektronike me më shumë se një pozicion - 420.00 (katërqind e njëzet) euro për çdo pozicion-ulëse në muaj kalendarik.

- 3.7. Tombolat bingo në lokale të mbyllura 140.00 (njëqind e dyzet) euro për lokal për çdo muaj kalendarik.
- 3.8. Lotaria e Kosovës - 18% (tetëmbëdhjetë përqind) të vlerës së tiketave të shitura për çdo muaj kalendarik.
- 3.9. Lojërat Keno 18% - (tetëmbëdhjetë përqind) të vlerës së tiketave të shitura për çdo muaj kalendarik, sipas raportit të qarkullimit nga Lotaria e Kosovës.
4. Ky vendim shfuqizon vendimin Nr. 03/13 të datës 29.04.2011.
5. Obligohet Ministria e Financave dhe Dogana e Kosovës për zbatimin e këtij vendimi.
6. Vendimi hyn në fuqi pas konsultimeve të zhvilluara me Komisionin për Buxhet dhe Financa, ndërsa zbatimi i paragrafit 3 fillon të zbatohet nga data 1 Gusht 2015.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/39
Datë: 22.07.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 22 korrik 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës për anëtar të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës, Kuvendit të Republikës së Kosovës i propozon z. Elbasan Dervishaj.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që propozimin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për emërim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/39

Datë: 22.07.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, duke u bazuar në Marrëveshjen e Brukselit përkatësisht në Ligjin nr. 04/L-199 për ratifikimin e Marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, në mbledhjen e mbajtur më 22 korrik 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen konkluzionet e dakorduara për Shpërbërjen e të Ashtuquajturës "Mbrotjtja Civile" e cila ka funksionuar në komunat veriore të Kosovës.
2. Qeveria e Republikës së Kosovës mbështet zotimet e përcaktuara me këto konkluzione.
3. Obligohen ministritë dhe agjencitë përkatëse që të bëjnë zbatimin e konkluzioneve sipas përgjegjësive ligjore duke përfillë aneksin e konkluzioneve sipas paragrafit 1. të këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/39
Datë: 22.07.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 22 korrik 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Plani Inicial për krijimin e Agjencisë së të Hyrave.
2. Obligohet Ministria e Financave dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/39

Datë: 22.07.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4.1. dhe 5.1 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (G.Z. Nr. 31/15 qershor 2008), nenin 36.1 dhe 137 të Ligjit Nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare (G.Z. Nr. 39/01 tetor 2008) duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 22 korrik 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Bordit të Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike Korporata "PTK-Sh.A" për ndërrimin e emrit të Korporatës nga "PTK-Sh.A" në "Telekomi i Kosovës" Sh.A.
2. Obligohet Telekomi i Kosovës Sh.A. të filloj procedurat e nevojshme ligjore për ndryshimet dhe regjistrimin e emrit në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/39

Datë: 22.07.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe të Rregullores nr. 06/2012 për Pozitat e Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 22 korrik 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Z. Ahmet Zejnullahu i vazhdohet mandati i Kryeshefit Ekzekutiv në Agjencinë Pyjore të Kosovës në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural edhe për tre (3) vjet.
2. Z. Zejnullahu kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
3. Obligohet Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/39

Datë: 22.07.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 22 korrik 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Programit Legjislativ të vitit 2015 të Qeverisë së Republikës së Kosovës

1. Në Programin Legjislativ të vitit 2015 bëhet ndryshimi dhe plotësimi i Projektligjeve si në vijim:
 - 1.1. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-70 për Siguri në Komunikacionin Rrugor, ndahet në tre Projektligje, si vijon:
 - 1.1.1. Projektligji për Patentë shofer, afati kohor korrik 2015;
 - 1.1.2. Projektligji për Rregullat e Komunikacionit Rrugor, afati kohor tetor 2015 dhe
 - 1.1.3. Projektligji për Automjete, afati kohor nëntor 2015.
 - 1.2. Projektligji për pagat e funksionarëve publik, Projektligji për pagat dhe kompensimet e nëpunësve publik të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil dhe Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-147 për pagat e nëpunësve civil fuzionohen në Projektligjin si në vijim:
 - 1.2.1. Projektligji për pagat që realizohen nga Buxheti i Republikës së Kosovës, afati kohor 17 gusht 2015.
2. Ngarkohet Zyra Ligjore në Zyrën e Kryeministrit për zbatimin e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë